

Data: 02 /08/ 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Restaurimi dhe Muzealizimi i Muzeut Etnografik Tiranë”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45454100-5 - Restaurime.

Vlera e fondit limit: 6,458,221.67 (gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzetë e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 8 (tetë) muaj.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 8 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *Shëmin:* Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 si dhe këstin përkatës për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Shërbime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se shërbimet e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me**

sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se shërbimet e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas kërkesave, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimet publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuader të vlerësimit të ofertave në menyre sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkepunimit; me marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tender as në menyre direkte dhe as në menyre indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

b-2) objekte social-kulturore; objekte kulti;

c- Projektim interiere;

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;

4. PROJEKTUES INSTALATOR

a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;

b) Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjise termike nga burime të rinovueshme;

c) Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;

f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit;

j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

8. PROJEKTUES GJEODET

a) Rilevime inxhinierike

9. STUDIM GJEOLGJIKO INXHINIERIK - HIDROGJEOLGJIK

a) Studim/vlerësim gjeologjik-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

b) Studime/vlerësime gjeologjiko-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Licensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
Projektues Arkitekt	b-2) objekte social-kulturore; objekte kulturi;	Projektim arkitektonik I objektit kulturor (monument kulture ne specifikat e veta konform kushteve per kete kategori objekti

	c- Projektim interiere;	<i>Projektim i mobilimit te brendshem nga ana funksionale, organizim I ineteriereve ne funksion te Muzeut qe po krijohet</i>
Projektues Konstrktor	a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	<i>Objekt me murature guri dhe balte me structure me cati druri, arkitrare druri etj.</i>
	d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prejbeton-arme, murature dhe metalike;	<i>Vleresime te kapacitetve mbajtese te struktures me konstruksion me murature guri. Strukturave te rrethimeve te objektit dhe strukturava te ngjashme.</i>
Projektues Instalator	a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;	<i>Projektim I linjave te shkarkimit, funksionimit te tyre</i>
	b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;	<i>Projektimi I impianteve te qarkullimit dhe ajrosjes, eskpertize ne integrimin e tyre me strukturat e vecanta te objektit e jo vetem</i>
	c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;	<i>Projektim I rrjeteve elektrike dhe sistemit elektrik, funizimi me energji per ndricimin e tj.</i>
	f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;	<i>Projektim I sistemeve te mbrojtjes nga zjarri, me sisteme qendrore hidraulike apo me bombula. Sisteme te modernizuara antizjarr.me qellim mbrojtjen e pasurise kulturore.</i>
	j) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.	<i>Projektim I sistemeve te alarmit dhe detektimit te tymit, sistemve te internet telefonise. Cdo instalim tjeter I telefonise, fonise, access kontroll ne keto kategori objektesh.</i>
Projektues i Veprave Hidraulike	b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.	<i>Projektim dhe ekzspertize per furnizimin me uje.</i>

Prorektues gjeodet	a) Rilevime inxhinierike	<i>Rilevime inxhinierike per te gjithe ketegorite e objekteve.</i>
Studim Gjeologo-Inxhinierik Hidrologjik	a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.	<i>Studim dhe vleresim I gjeologjis se truallit ku ndodhet objekti ekzistues dhe raportet per masat qe duhet te meren ne baze te studimit.</i>
Studime te Sizmologjise Inxhinierike	b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.	<i>Studime dhe vleresime te sizmologjise per objektet</i>

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi;
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;

Per stafin e percaktuar me siper Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë si dhe te figurojne ne listpagesa për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e fundit të deklaruar
- b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per per periudhen e fundit të deklaruar.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.9 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të fushes objekt prokurimi (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë shërbimin e kërkuar rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Specialiste duhet të jenë zoterues të licensave profesionale sipas paragrafit 2.3.2 për nderhyrjet në pasuritë kulturore materiale

2.3.4 License profesionale për nderhyrjet në pasuritë kulturore materiale (leshuar nga Keshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore) ku të përfshihen kategoritë:

Projektim: Arkitektura

P/A/5 – Konservim dhe restaurim i arkitektures së tradites (Vernakulare)

Gjinite: 25 Arkitektura e tradites

P/A/7 - Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

Projektim: Vepra Arti

P/V/3 – Konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru

Tipologjite: 3206 – Zbukurime në dru (tavane karakteristike, elemente dekorative me gdhendje në dru pjesë e gjinive të arkitektures së tradites

Per stafin e mesipër Operatori Ekonomik duhet të paraqesë ose **Kontratë Shërbimi** ose **Marrëveshje Bashkëpunimi** që disponojnë licensën e mësipërme ku të përfshihen kategoritë, *Diplomë* si dhe *CV*.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.9, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Gjithashtu bazuar ne vendimin Nr.792 dt. 07.10.2020, i ndryshuar me VKM Nr.329, dt. 02.06.2021 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, NËNKATEGORIVE TË LICENCAVE, PROCEDURAVE PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN, SI DHE KUOTIZACIONIT VJETOR TË LICENCAVE PËR NDRËHYRJET NË PASURITË KULTURORE MATERIALE

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt ikontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
Projektim Arkitekture	P/A/5 - Konservim dhe restaurim i arkitektures se tradites (vernakulare) Arkitetktura e trazites dhe zonifikimet	Monument culture I kategorise se pare, godine historike tradicionale me funksion baze vendbanimtipik historic te zones
	P/A/7 - Konservim restaurim i rikualifikim I hapësirave (rruge shesh Brenda qendrave historike dhe asambleve historike urbane.	Trajtimi I sheshit rreth godines. Sheshi perreth godines Brenda rrethimit, integrimi I elementeveorijinale te godines me sheshin dhe anasjelltas
Projektim Vepra arti	P/V/3 – Konservim dhe restaurim i veprave te artit ne dru (Zbulimorë i dru, (tavane karakteristike elemente dekorative me gdhendje ne dru, pjesë arkitektures se tradites.	Rozet ne tavanet e godines, elementet zburues drusore jashtme dhe te brendshme ne vetrata dhedyer.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbështetes (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë)

1. Drejtues Projekti

Të ketë së paku një diplomë master ose ekuivalente universitare në Etnografi.

2. Studiues i arkitekturës tradicionale

Ai/ajo duhet të ketë së paku një diplomë master ose ekuivalente universitare në Arkitekturë.

Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që lidhen me krijimin, restaurimin, rehabilitimin apo rikonceptimin e muzeve në vend ose jashtë.

Përvojë në projekte të dizajnit të brendshëm dhe ndërhyrje në ndërtime që janë objekte të trashëgimisë dhe të jetë i pajisur me liçence restaurimi të lëshuar nga Ministria e Kulturës, që të përmbajë në pikat e licensimit kategorinë përkatëse të projektimit.

3. Historian

Ai/ajo duhet të ketë së paku një diplomë master ose ekuivalente ne fushen perkatese.

4. Muzeolog

Diplomë në fusha si Muzeologji/Histori/Arkivistikë/Trashëgimi Kulturore/Etnografi.

Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që lidhen me muzealizimin e cila vertetohet me kontrata per:

- pune në projekte të ngjashme (si: projekte muzeale, ekspozita, dizajn të brendshëm, etj.).
- Projekte të hartuara të vendosura në zona të trashëgimisë kulturore si: rehabilitimi i aseteve kulturore, restaurim, adaptim, etj.

Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që kanë patur në fokus të tyre muzealizimin.

5. Kurator i ekspozitave (dhomave)

Master në Arte Pamore dhe Studime Kuratoriale ose diplomime dhe kualifikime të ngjashme në Arte Pamore dhe Performuese, Menaxhim Artesh

6. Projektues i multimedias

Diplomë Master në Marketing, Multimedia, Web, Dizajn Grafik, Komunmikim Vizual ose ekuivalente.

7. Përkthyes

Diplomë në përkthim të gjuhës angleze.

8. Redaktor

Diplomë në gjuhë /letërsi shqipe ose gazetari.

9. Ekspert i komunikimit

Diplomë në shkenca komunikimi.

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, CV, Diplomë dhe cdo kualifikim tjeter qe verteton mbulimin e fushave te mesiperme.

Një punonjes nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references dhe pikave te licenses te kerkuara ne piken 2.3.1.

Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) punonjës Ekspert Zjarrëfikës
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikes*, është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin“, *ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.*

Theksojmë se, për shkak të natyrës së shërbimit objekt prokurimi shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës dhe shkallës së vështirësisë për objektet që parashikohen të jenë pjesë e kesaj marreveshjeje dhe efektshmerine në projektimin me sukses të tyre.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **17** (shtatembdhjetë) punonjës.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.9 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore

minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References dhe stafin e permendur ne pikat e mesiperme *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre.*

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te citohet lista e te gjithë stafit i cili do te jete i angazhuar ne kete kontrate.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Lista e stafit: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References dhe stafin e permendur ne pikat e mesiperme *Lista e stafit te cilet do te kryejne sherbimit e kerkuar, i jepautoritetit kontraktor besueshmëri dhe siguri duke i vene ne dispozicion personat te cilen do te kryejne sherbimin sipas kerkesave te ketij objekt kontrate.*

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** per objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise (menaxhim i kualifikuar i sistemit te operimit dhe cilesise);
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nganjë organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;

Certifikata e Sistemit te Menaxhimit te Cilesise (Quality Management System - QMS): Ky standard ka te beje me menaxhimin e cilesise dhe sigurimin e proceseve te projektit. Certifikimi sipas ISO 9001 konfirmon se studioja ka vendosur standarde te larta per proceset e saj dhe ka nje sistem efektiv te menaxhimit te cilesise.

b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;

Certifikata e Sistemit te Menaxhimit te Ambientit (Environmental Management System - EMS): Nje studio projektuese qe merret me dizajnimin e projekteve ndikon ne ambientin, keshtu qe certifikimi sipas ISO 14001 tregon qe studioja angazhohet per te pasuruar mjedisin dhe t'i minimoje ndikimet negative ne ate.

c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit per Shendetin dhe Sigurine ne Punë;

Certifikata e Sistemit te Menaxhimit te Sigidurise dhe Shendetit ne Pune (Occupational Health and Safety Management Systems - OHSMS): Ky standard konfirmon se studioja ndjek nje sistem efektiv te menaxhimit te sigurise dhe shendetit te punonjesve te saj, duke garantuar nje mjedis pune te sigurte dhe te shendetshem per ekipin e saj.

Kërkesat per kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me fushat e zbatimit te pjesëmarrjes në kete shërbim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.